



## **Përditësim për shtypin**

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut, dhe Hajredin Kuçit për ndikim të pretenduar ndaj dëshmitarëve, seancat e planifikuara paraprakisht për datat 24 dhe 28 prill janë anuluar.

Mbrojtja kërkoi që dëshmitë e të gjithë dëshmitarëve të saj të merren nga Gjykatësi i Vetëm në formë të shkruar dhe që ata të mos thirren për të dëshmuar në seanca gjyqësore. Gjykatësi i Vetëm tani ka miratuar kërkesën në fjalë për pesë nga shtatë dëshmitarët në listën e Mbrojtjes, që çoi në anulimin e seancave gjyqësore. Vendimi për dy dëshmitarët e tjerë të Mbrojtjes do të merret në kohën e duhur.

Në të njëjtën çështje, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi palët që deri më 22 prill të dorëzojnë parashtrime me shkrim për disa aspekte që lidhen me caktimin e seancave për pjesën e mbetur të gjykimin. Gjykatësi caktoi datën 5 maj si afat paraprak për dorëzimin prej Mbrojtjes të njoftimeve për mbylljen e paraqitjes së provave të tyre përkatëse. Pas marrjes së parashtrimeve të palëve, Gjykatësi i Vetëm do të vendosë lidhur me kalendarin e seancave për pjesën e mbetur të gjykimin.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, më 17 prill Trupi Gjykues miratoi një kërkesë të Mbrojtjes së Viktimave për të lejuar dy familjarë të ngushtë të një viktime të vdekur për të vijuar me pjesëmarrjen e viktimës në proces. Rrjedhimisht, numri total i viktimave pjesëmarrëse në këtë çështje është shtuar në 156.

Në të njëjtën çështje u bënë publike vendime të mëparshme në lidhje me paraburgimin e të akuzuarve, përfshirë vendimi i Trupit Gjykues i 16 marsit 2026 për zgjatjen e paraburgimit të Rexhep Selimit. Në këtë vendim, gjykatësit konstatuan se vazhdojnë të ekzistojnë rreziqet që të akuzuarit mund të pengojnë procesin ose të kryejnë vepra penale të tjera, duke theksuar se rreziku i ndërhyrjes përfshin gjithashtu orvatjet për t'u hakmarrë ndaj dëshmitarëve që kanë dëshmuar në proces apo orvatjet për t'i motivuar dëshmitarët të tërheqin dëshmitë e tyre.

Dy vendime të tjera të bëra publike së fundi, të datës 4 korrik 2025 dhe 19 mars 2026, zbusin në mënyrë konkrete masat e caktuara nga Trupi Gjykues për vizitat që u bëhen tre të paraburgosurve.

Kujtojmë se në dhjetor 2023, Trupi Gjykues caktoi disa masa në lidhje me vizitat personale jo të privileguara të z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Selimi. Trupi Gjykues ndërmori këtë pasi prova të paraqitura nga ZPS-ja dukej se tregonin që të paraburgosurit po u zbulonin informacion konfidencial nga procesi gjyqësor vizitorëve të tyre dhe se kushtet e zakonshme të paraburgimit ishin të pamjaftueshme për të zvogëluar rrezikun që të





paraburgosurit të ndërmerrnin veprime që mund të ndërhyjnë në proces ose që përbënin rrezik për sigurinë e dëshmitarëve.

Masat shtesë të caktuara në dhjetor 2023 përfshinin mbikëqyrjen aktive të vizitave personale për këta tre të paraburgosur. Kjo mbikëqyrje nuk zbatohet ndaj takimeve konfidenciale midis të pandehurve dhe mbrojtësve të tyre, apo ndaj vizitave private me bashkëshortet dhe fëmijët. Këto takime janë zhvilluar gjithmonë pa mbikëqyrje. Po ashtu, këto masa nuk u zbatuan ndaj të paraburgosurve të tjerë.

Në vendimin e 4 korrikut 2025, Trupi Gjykoës hoqi disa prej këtyre masave në lidhje me z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Selimi, për shembull hoqi kufizimin e pjesëmarrjes vetëm të një vizitori për vizitat me videolidhje me anëtarë të ngushtë të familjes.

Në vendimin e 19 marsit, Trupi Gjykoës zbuti më tej disa masa për të tre të paraburgosurit, ndërsa rrëzoi një kërkesë të Mbrojtjes së Selimit për të hequr kufizimet e mbetura për kontaktet e Rexhep Selimit.

Në lidhje me zbutjen e masave, Trupi Gjykoës në vendimin e marsit shtoi numrin e vizitave fizike jo të privileguara të autorizuara, nga pesë në gjashtë në muaj, dhe u pajtua me ndryshimet e parapara nga Administratorja që do t'u mundësojnë tre të akuzuarve të kërkojnë dy vizita shtesë me videolidhje në muaj me të afërt të ngushtë dhe një vizitë private shtesë në muaj me bashkëshortet dhe fëmijët.

Në vendim gjykatësit shprehën vlerësimin se kushtet e modifikuara të paraburgimit “nuk ndërhyjnë në mënyrë të palejueshme ndaj të drejtës së tre të akuzuarve për respektim të jetës familjare” dhe vunë në dukje se “kushtet e modifikuara të paraburgimit të përcaktuara në këtë vendim, për disa aspekte, përputhen me, ose krijojnë të drejta shtesë në lidhje me vizitat krahasuar me rregulloren e paraburgimit.”

Sistemi i zbatueshëm garanton që çdo i paraburgosur të ketë mundësi të arsyeshme për të ruajtur marrëdhëniet personale, përfshirë kontakte të përditshme me familjen dhe shokët përmes thirrjeve telefonike dhe korrespondencës, përveç vizitave fizike dhe me videolidhje.

